




Nr. 880 prot  
Dt. 24.05.2021



Prot. 365  
Datë 24.05.2021

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË (ASHSH)

DHE

UNIVERSITETIT ISMAIL QEMALI TË VLORËS (UV)

Neni 1

Baza ligjore

Kjo marrëveshje nënshkruhet në bazë të Ligjit 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe të Ligjit nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Përcaktimi i Palëve

Palët në këtë Marrëveshje janë:

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH), me qendër në Tiranë, sheshi *Fan Noli*, 1001, e përfaqësuar nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar;
2. Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës (më tej: UV), me qendër në qytetin e Vlorës, i përfaqësuar nga prof. dr. Roland Zisi, Rektor.

Neni 3

Qëllimi

Marrëveshja ka për qëllim rregullimin e bashkëpunimit ndërinstytucional midis *Palëve*, si dhe midis strukturave përbërëse të tyre; përcaktimin e prioriteteve themelore të bashkëpunimit dhe mënyrën e zbatimit të tyre,

mbështetur në legjislacionin në fuqi, në parime të gjithëpranuara dhe në interesa të përbashkëta.

#### Neni 4 Parime bazë

Parim themelor rregullues për bashkëpunimin e *Palëve* është *liria akademike dhe autonomia universitare*. Ato bashkëpunojnë duke respektuar njëra-tjetrën në *vetëveprimin e tyre të rregulluar me ligje dhe me akte nënligjore*, duke ruajtur dhe zhvilluar traditat më të suksesshme të këtij bashkëpunimi, përmes nismash, projektesh e veprimtarish të përbashkëta akademike e universitare.

Në veprimtaritë e përbashkëta dhe jashtë tyre *Palët* pranojnë dhe respektojnë *Kodin europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor*. Ato mbajnë qëndrim kritik dhe të papajtueshëm ndaj të gjitha formave të plagjiaturës dhe manipulimit.

#### Neni 5 Drejtimet kryesore të bashkëpunimit

Bashkëpunimi midis *Palëve* shtrihet në gjithë fushat e dijes dhe shkencës.

*Palët* bashkëpunojnë me përparësi në shkencat albanologjike: *gjuhësi, histori, antropologji kulturore, trashëgimi shpirtërore e identitare, studime letrare e kulturore, shkenca ekonomike e sociale*; si dhe në disiplina të shkencave natyrore e teknike: *matematikë-fizikë; bioshkenca, bioteknologji dhe shkenca të jetës*; duke përfshirë disiplinat që kanë lidhje me fusha imperative, si *pandemitë* etj.

*Palët* bashkëpunojnë për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore, si: kuvende, kongrese, konferenca, forume, simpoziume etj.

*Palët* bashkëpunojnë për kryerjen e studimeve të përbashkëta dhe botojnë ndërsjelltas në buletinet e veta shkencore artikuj të studuesve të tyre.

*Palët* bashkëpunojnë për aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta shkencore vendore, rajonale dhe europiane.

*Palët* bashkëpunojnë për nxitjen dhe promovimin e studuesve të rinj.

#### Neni 6 Bashkëpunime të veçanta

Njësitë bazë të studimit dhe senati akademik i Universitetit të Vlorës marrin pjesë në procesin e promovimit të kandidatëve për anëtarë të Asamblesë së

ASHSH, në zgjerim të traditave të mirënjohura të bashkëpunimit ekzistues, siç parashikohet në Ligjin dhe në Statutin e saj.

ASHSH fton përfaqësues të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës të marrin pjesë si *anëtarë jurie, vlerësues të jashtëm, recensues dhe oponentë* në organizimin e konkurseve shkencore për *çmimet kombëtare vjetore* të shpallura prej saj, në të gjitha fazat e tyre; si dhe në procesin *peer review* të periodikëve dhe botimeve shkencore.

Përfaqësues të Universitetit të Vlorës marrin pjesë si bashkëpunëtorë në organizma që funksionojnë pranë ASHSH, si *Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, komiteti kombëtar i AIESEE-së, këshilli i botimeve akademike etj.*, si dhe në realizimin e nismave dhe projekteve madhore akademike.

ASHSH fton rregullisht në mbledhjet vjetore të Asamblesë së saj përfaqësues të Universitetit të Vlorës.

ASHSH dhe Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës ofrohen për bashkëpunim për hartimin e programeve të veçanta të studimeve universitare për shkallët *master dhe doktoratë*, si dhe për drejtimin shkencor të tyre.

#### Neni 7

##### Shkëmbimi i botimeve dhe i informacionit

*Palët* i sigurojnë njëra-tjetrës shkëmbimin e ndërsjelltë dhe të pakushtëzuar të informacionit shkencor, të periodikëve që botojnë, të studimeve dhe monografive. ASHSH i dhuron periodikisht koleksione të botimeve të saj bibliotekës shkencore të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.

*Palët* shkëmbejnë *ekspertiza dhe mbikëqyrje* të përbashkëta të veprimtarisë shkencore në ekspedita dhe në kërkime.

*Palët* informojnë rregullisht njëra-tjetrën për marrëveshjet dy ose shumëpalëshe me interes të ndërsjelltë.

#### Neni 8

##### Protokollet e bashkëpunimit

Me vullnetin e *Palëve* kësaj Marrëveshjeje i bashkëlidhen protokolle bashkëpunimi me afate realizimi që përcaktohen me diskutim mes tyre. Protokolle mund të nënshkruhen dhe për një veprimtari të vetme.

**Neni 9**  
**Zbatimi dhe kohëzgjatja**

**Kjo Marrëveshje ka fuqi veprimi me kohë të papërcaktuar.**

**Palët takohen dy herë në vit për të vlerësuar ecurinë e Marrëveshjes.**

**Ndërprerja e saj pranohet prej Palëve në rastet kur:**

- **Ndryshon statusi ligjor i institucioneve dhe ky ndryshim prek funksionet themelore të tyre, me efekt në Palën tjetër;**
- **Njëra nga Palët shpreh me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar shqetësimin për cenimin e interesave bazë të saj në procesin e plotësimit të kushteve të kësaj Marrëveshjeje.**

**Neni 10**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

**Kjo Marrëveshje është çështje dypalëshe. Për paqartësitë dhe ankesat e mundshme Palët nuk kërkojnë apelim në ndonjë instancë tjetër. Mosmarrëveshjet midis Palëve zgjidhen me bisedime.**

**Në rast të mosarritjes së dakordësisë për një periudhë prej gjysmë viti për çështje të diskutueshme, kjo Marrëveshje e humbet fuqinë.**

**Neni 11**  
**Të fundme**

**Kjo Marrëveshje nënshkruhet në dy kopje, të dyja në gjuhën shqipe, një për secilën Palë, me vlerë të barabartë.**

**Për:**

**Universitetin "Ismail Qemali"**  
**të Vlorës**

**Akademinë e Shkencave**  
**të Shqipërisë**

**Prof. dr. Roland Zisi**  
**Rektor**

**Akad. Skënder Gjinushi**  
**Kryetar**

Vlorë, më 24.05.2021

